



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .04.2023

**MBLEDHJA Nr. 19,**  
**Datë 07.04.2023, ora 12:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 07.04.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 19 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 30.03.2023 dhe 04.04.2023
2. Mbi kërkesën e shoqatës “AREA” për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 27, datë 16.02.2023, “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 67, datë 08.02.2023”
3. Mbi ditën e fillimit të tregtimit të tregut të Ditës në Avancë të ALPEX
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 203 datë 13.09.2018
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 202, datë 13.09.2018
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferim (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të centralit fotovoltai Blue 1, në favor të Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, SICAV-SIF
7. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2022, “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së “ALBGAZ” sh.a.”

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**